

VENDIM
Nr. 79, datë 12.3.2026

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DEVOL HYDROPOWER” SHA
PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË
ORIGINËS DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR
HEC “MOGLICË” DHE HEC “BANJË”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 660/1 prot., datë 11.3.2026, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Devol Hydropower’ sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC ‘Moglicë’ dhe HEC ‘Banjë’”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a.

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 9.6.2016, nga HEC-et e kaskadës së lumit Devoll, përkatësisht për HEC “Moglicë” dhe HEC “Banjë”. Gjithashtu, kjo shoqëri është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.3.2015, i ndryshuar dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 4.3.2015, të ndryshuar.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. me shkresën nr. 660 prot. datë 16.2.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe për regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC “Moglicë” dhe HEC “Banjë”.

- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit HEC-eve përfshirë karakteristikat teknike të secilit prej tyre, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, si dhe të pikës së matjes.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se impiantet për të cilat kërkohet regjistrimi janë hidrocentrale me rezervuar, të cilët klasifikohen si impiante të përshtatshme për lëshimin e garancive të origjinës sipas nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

- Gjithashtu, nga informacioni i paraqitur rezulton se këto impiante nuk janë të pajisura me sistem pompimi kthyes, dhe për rrjedhojë nuk përjashtohen nga përfitimi i garancive të origjinës, në përputhje me nenin 22, pika 7, të ligjit nr. 24/2023.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistrë si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.
Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC “Moglicë” dhe HEC “Banjë”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti